



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
*Seksioni i Veçantë*



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201600824/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** Rekomandojmë që të merren masa ligjore, për zgjidhjen e problemit të personave me masa mjeksore dhënë nga gjykatat për "Mjekim të detyruar" dhe nxerrjen e këtyre personave jashtë sistemit të burgjeve dhe kalimi i tyre në institucione të posaçme mjeksore, në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

**Drejtuar :** **Z. Ylli MANJANI**  
**MINISTËR I DREJTËSISË**

**Z. Adriatik LLALLA**  
**PROKUROR I PËRGJITHSHËM**

**TIRANË**

**Për dijeni :** **Z. Edi RAMA**  
**KRYEMINISTËR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**TIRANË**

***I nderuar zoti Ministër i Drejtësisë,***

Në ankesën e tij datë 18.04.2016, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi A.H. i cili ndodhet duke vuajtur masën mjeksore të "Mjekimit të detyruar" në I.E.V.P. Krujë, të dhënë nga Gjykata ka kërkuar ndihmën e institucionit tonë që atij t'i mbrohen dhe respektohen të Drejtat e Njeriut, dhe ai të vendoset për trajtim shëndetësor në një nga Spitalet për trajtimin e personave me probleme psikike, që ndodhen në Tiranë ose në Vlorë.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se me vendimin Nr.10 datë 17.03.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur vazhdimin e masës mjeksore, "Mjekim i detyruar" në një nga Spitalet për trajtimin e personave me probleme psikike në Tiranë ose në Vlorë, ndaj shtetasit A.H. Me shkresën e saj Nr.3360 prot, datë 07.04.2016 Organi i Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit për masën mjeksore "Mjekim i detyruar", në një nga institucionet mjeksore ndaj shtetasit A.H. dhe për këtë ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dhe Ministria e Shëndetësisë Tiranë për ekzekutimin e tij.

Në bazë të këtyre akteve ligjore shtetasi A.H. mbahet padrejtësishtë në I.E.V.P. Krujë, dhe me të drejtë ai ka kërkuar të ndërhyhet nga institucioni ynë

që ai të qëndrojë në Spital sipas përcaktimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, dhe të ripërcaktuar ky fakt edhe në urdhërin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, të lëshuar nga organi i Prokurorisë.

Veprimet dhe qëndrimet e mbajtura nga organi i Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ai i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, dhe i I.E.V.P. Krujë, në rastin konkret është jo vetëm i padrejtë por edhe në kundërshtim me ligjin dhe aktet e tjera normative, dhe më konkretisht :

1.Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 142/3 ku parashikohet se: ***“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”***.

2.Kodit Procedurës Penale, nenet 24/1, 462, 463 dhe 464 ku parashikohen ***detyrat e Prokurorit për të vënë në ekzekutim një vendim gjyqësor, menjherë sapo ai të ketë marrë formë të prerë***.

3.Ligji Nr.8331 datë 21.04.1998”Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në bazë të kërkesave të nenit 2, 9, 22 ku parashikohen ***detyrimet e Prokurorit për të marrë masa për ekzekutimin e vendimit në përputhje me urdhërimet e Gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji***.

Në vendin tone aktualisht nuk ka një institucion të veçantë mjeksor për persona që vuajnë nga trubullime psikike ose neuropsiqike dhe këto persona nuk duhet të mbahen në burgje por në institucione të veçanta mjeksore, të cilat duhen ngritur sa më shpejt të jetë e mundur. Duke ju referuar dokumentit, ”Mbi Rregullat Europiane të Burgut”, miratuar nga Këshilli i Europës dhe deleguar për zbatim me Rekomandimin me Nr.87/3 të Këshillit të Ministrave të vendeve antare nëpërmjet shumë rregullave të këtij dokumenti veçohet pika 100.1 që përcakton se:”

***Personat që konstatohen me probleme të shëndetit mendor nuk duhet të mbahen në Burg, por duhet të dërgohen sa më shpejt që të jetë e mundur nga Burgjet, në vende të përshtatshme për këtë kategori personash”***.

Po kështu në nenin 28 pika 1 të Ligjit Nr.144/2012”Për Shëndetin Mendor”, përcaktohet se: ***“Institucionet mjeksore të posaçme janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me ç’rregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale, për të cilat Gjykata kompetente ka vendosur “Mjekimin e detyruar”, në një institucion mjeksor të të paraburgosurve dhe të të dënuarve, që shfaqin ç’rregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët, Gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion të posaçëm, në bazë të nenit 239 të Kodit Procedurës Penale”***.

Në këto kushte ne gjykojmë se ***Ministria e Drejtësisë, duhet të marrë masat e nevojshme institucionale e ligjore, për nxjerrjen e këtyre personave jashtë sistemit të burgjeve, dhe të bëhet kalimi i tyre menjherë në institucione të posaçme shëndetësore që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë***. Shkeljet e konstatuara në rastin konkret për shtetasin A.H. janë në kundërshtim edhe me nenin 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ***pasi të sëmuret mendor nuk mund të diskriminohen për shkak të statusit të tyre si persona me probleme të shëndetit mendor***.

Po kështu konstatohet se këto veprime të këtyre organeve shtetore dhe shkelje të të Drejtave të Njeriut, vijnë në kundërshtim edhe me nenin 15 dhe 28 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se:”

***Të drejtat dhe liritë themelore të Njeriut, janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribojnë në realizimin e tyre.***

Në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, thuhet se: ***”Avokati i Popullit, ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, nga administrata publike”.***

Po kështu në nenin 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, thuhet se:

***”Pas përfundimit të hetimit, “ Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkatuar shkelje, e të të drejtave dhe lirive”,***

Për sa më sipër, ju

#### **REKOMANDOJMË :**

1.Marrjen e masave ligjore për zgjidhjen e këtij problemi dhe nxjerrjen e këtyre personave jashtë sistemit të burgjeve, dhe kalimi i tyre në institucione të posaçme mjekësore, në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj në bazë të kërkesave të nenit 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda afatit 30 ditor.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

Në mungesë dhe me porosi të tij

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**